

UDHËZIMET PËR TARIFAT KOMBËTARE

UDHËZIM

Nr .29, datë 18/12/ 2014

”PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARATEVE TELEVIZIVE”

Agjenti OSHEE; Fletore Zyrtare 196/2014

UDHËZIM

Nr .30, datë 23/12/2014

”PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E RADIOKOMUNIKACIONIT”

Agjenti AKEP; Fletore Zyrtare 196/2014

UDHËZIM

Nr.32, datë 29/12/2014/2014

“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE”

Agjenti AMA ; Fletore Zyrtare 206/2015

UDHËZIM

Nr .33, datë 29/12/2014

**“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË
ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, "PËR
SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR "SHTETËROR", PROKURORISË DHE
NOTERISË ”**

Agjenti; Administratat respektive të këtyre institucioneve dhe për shërbimin noterial Posta Shqiptare,
sh.a. ; Fletore Zyrtare 206/2015

UDHËZIM

Nr.34 , datë 29/12/2014

**“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR
PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI“**

Agjenti DPSHTRR; Fletore Zyrtare 206/2015

UDHËZIM

Nr. 37 datë/31/12/2014

**“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET
KONSULLORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME APO TË AMBASADAVE
TONA JASHTË VENDIT“**

Agjenti MPJ; Fletore Zyrtare 206/2015

Agjenti OSHEE

UDHËZIM

Nr .29, datë 18/12/ 2014

**”PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E
APARATEVE TELEVIZIVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar,

UDHËZOJNË:

"1. Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive është 100 (njëqind) lekë në çdo muaj kalendarik".

2. Tarifa paguhet nga përdoruesit familjarë dhe nga përdorues të tjerë jo familjarë. Përdoruesit familjarë paguajnë tarifën vetëm për një marrës televiziv, pavarësisht nga numri i aparateve që kanë në familje. Përdoruesit e tjerë jofamiljarë paguajnë tarifën për çdo aparat televiziv.

"3. Operatori I Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) caktohet agjent për mbledhjen e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive. Mbledhja e kësaj tarife bëhet çdo muaj".

"4. Faturat tatimore të energjisë elektrike të OSHEE-së do të kenë në fund, si një zë më vete, tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave për tatimin mbi vlerën e shtuar.

5. Mbi tarifatat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet tatimi mbi vlerën e shtuar.

"6. Pagesat e tarifës vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike, ku shënohet "tarifa e paguar për muajin___, data e pagesës, si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj tarife."

7. OSHEE-ja në cilësinë e agentit të mbledhjes të kësaj tarife është i detyruar;

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzimin nr. 26, datë 4.09.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të Ministrit të Financave.

Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga OSHEE nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. OSSH duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifën .

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

8.Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive:

a) Për përdoruesit familjarë

-Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar", të ndryshuar, ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë zyrës së OSHEE, sh.a., në momentin e pagesës së faturës së energjisë elektrike, librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga tarifa. Nëpunësi i zyrës së "OSSH" sh.a., mban një kopje të librezës, në të cilët vendoset shënimi "përjashtuar nga tarifa".

b) Për përdoruesit jo familjarë :

-përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në bazë të parimit të reciprocitetit;

-bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave;

-faturimi i energjisë elektrike për aktivitete, të tilla si: miniera, ujësjellësa, pusët e naftës, furnizimi i antenave të telefonisë celulare"ndriçimi publik i rrugëve". dhe garazhe të mjeteve lëvizëse;

-në rastet kur palë në kontratën e konsumit të energjisë elektrike është një subjekt që operon në sektorin e ndërtimit, tarifa llogaritet dhe paguhet nga momenti i kalimit të kontratës në emër dhe për llogari të personit fizik, juridik apo individit pronar i ambientit për të cilin faturohet energjia.

9. Institucionet e përcaktuara në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi i përcjellin kompanisë OSHEE, brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse, nëse ka."

10. Për shërbimin e kryer, OSSH mban 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 90% të shumës së arkëtuar.

OSHEE-ja, vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimeve nga tarifat për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton si dhe deklaron dhe paguan në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

7. Udhëzimi nr. 1, datë 8.1.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive", i ndryshuar, shfuqizohet .

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE

SHKËLQIM CANI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

I RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Martin Leka

SHTOJCA NR. 1

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT MBI KATEGORITË E PËRJASHTUARA

Emërtimi, përshkrimi i kategorive, institucionet përgjegjëse për dhënie të informacionit mbi kategoritë e përjashtuara

Të verbrit/ paraplegjikë/tetraplegjikë,

Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH).

Veteranë lufte,

Ministria e Mbrojtjes.

Invalid pune,

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR
2015 Tarifat Kombëtare dhe Udhëzimet

Përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën

e Shqipërisë në bazë të parimit të reciprocitetit,

ambasadat

Ministria e Punëve të Jashtme.

Bashkësitë fetare:

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë,

Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria
Ungjillore e Shqipërisë, Komuniteti Shtetëror për Kultet.

Faturimi i energjisë elektrike për aktivitete, të tilla si:

miniera, ujësjellës, puset e naftës, furnizimi i antenave

të telefonisë celulare, ndriçimi publik i rrugëve dhe garazhet

e mjeteve lëvizëse, miniera,

Ministria e Energjetikës. Dhe Industrisë

Ujësjellës,

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës .

Puse naftë,

Ministria e Energjië dhe Industrisë .

Antena celulare,

Autoriteti i Komunikimeve Elekteromike dhe Postare. (AKEP)

Ndriçimi publik i rrugëve,

Bashkitë.

Garazhet e mjeteve lëvizëse,

Sipas përcaktimeve të bëra në faturën e energjisë.

Agjenti AKEP

UDHËZIM

Nr .30, datë 23/12/2014

**”PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E
RADIOKOMUNIKACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008
"Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe
Postare (AKEP)

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit llogaritet duke shumëzuar numrin e pikëve (Pt) me koeficientin K, ku pikët (Pt) përcaktohen sipas tabelave respektive të Shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe koeficienti (K), që është unik për të gjitha shërbimet, ka vlerën 1000 lekë/pikë.

2. Koha e llogaritjes së tarifës do të bëhet në bazë javore, sipas tabelave të shtojcës nr.1 të këtij udhëzimi. Tabela e fundit "Formula e përgjithshme" e Shtojcës nr. 1, shfuqizohet.

3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) caktohet agjent për mbledhjen e tarifës së shërbimit për shërbimet e radio-komunikacionit.

4. Tarifa e shërbimit është vjetore, dhe deklarohet nga agjenti mbi bazë mujore.

5. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në cilësinë e agjentit të mbjedhjes të kësaj tarife është i detyruar;

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguaj për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.09.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të Ministrit të Financave. Deklarata plotësohet dhe dorëzohet në vetëm në mënyrë elektronike nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve [ëëë.tatime.gov.al](http://ee.tatime.gov.al). Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. AKEP , duhet të dorëzojnë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifën .

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

6. Për shërbimin e kryer, AKEP mban 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 95% të shumës së arkëtuar.

AKEP vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim me vlerën e arkëtimeve nga tarifat për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton, si dhe deklaron dhe paguan në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

7. Udhëzimi 28, datë 6.10.2008 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit shfuqizohet.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare . Ky

udhëzim publikohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më datë 1.1.2016.

Ndryshuar me Udhëzim nr. 28, datë 12.1.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 205, datë 1 dhjetor 2015.

Shtojca 1 : TARIFAT PËR SHËRBIMET E RADIOKOMUNIKACIONIT

Tabela A-1 LIDHJE FIKSE RADIO-RELE (LIDHJE FIKSE MIKROVALORE MBI 1 GHz)					
TH DHËNAT E LIDHJES					VARIABLAT E VLERESUAR
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (F)	Kapaciteti i transmetimit (C)	Distanca e lidhjes (D)	Koha e vlefshmërisë (V _E)	FORMULA
Sipas përcaktimit në licencë / autorizim / leje përdorimi					$P_t = B \cdot F \cdot E \cdot D \cdot C \cdot V_E$ (pake)
					Sipas tabelës së mëposhtme
VARIABLAT E VLERESUAR		MDALJA		VLERA E VARIABELIT	
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve të CEPT dhe ITU		Sania në MHz	
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	F	1 GHz - 5 GHz		2.0	
		5 GHz - 10 GHz		2.5	
		10 GHz - 25 GHz		1.8	
		Mbi 25 GHz		1.5	
Përdorim i përbashkët / ekskluziv	E	Përdorim i përbashkët		1.0	
		Përdorim ekskluziv		Nuk zbatohet	
Distanca e lidhjes	D	D ≤ 15 km		1.0	
		15 < D ≤ 40 km		1.2	
		40 < D ≤ 80 km		1.4	
		Mbi 80 km		1.5	
Kapaciteti i transmetimit	C	Transmetim analog	Radio	12.0	
			Televizion (TV)	1.5	
		Transmetim digital	C ≤ 8 Mbit/s	1.2	
			8 Mbit/s < C ≤ 34 Mbit/s	1.1	
			34 Mbit/s < C ≤ 155 Mbit/s	0.9	
			Mbi 155 Mbit/s	0.8	
Koha e vlefshmërisë	V _E	Për çdo javë. Një muaj brenda 4 javë, një vit brenda 52 javë		0.02 / për javë	

Tabela A-2

LIDHJE NDERMJET DY STACIONEVE FIKSE (LIDHJE FIKSE POSITE 1 GHz)

TE DHENAT E LIDHJES				VARIABLAT E VLERESUAR						FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (f)	Distanca e lidhjes (D)	Koha e vlefshmërisë (V _r)	B	f	E	D	Pr	V _r	$P_t = B \cdot f \cdot E \cdot D \cdot Pr \cdot V_r$ (pikë)
Sipas paraktimit në licencë / autorizim / leje përdorimi				Sipas tabelës së mëposhtme						

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERJA E VARIABLIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve të CEPT dhe ITU	Sasia në MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	f	Deri në 30 MHz	50.0
		30 MHz - 100 MHz	70.0
		100 MHz - 300 MHz	110.0
		300 MHz - 1000 MHz	90.0
Përdorim i përshkaktet / ekskluziv	E	Përdorim i përshkaktet	1.0
		Përdorim ekskluziv	Nuk zbatohet
Distanca e lidhjes	D	D ≤ 15 km	10.0
		15 < D ≤ 40 km	16.0
		40 < D ≤ 80 km	35.0
		Mbi 80 km	50.0
Proccitëti sipas PKRF (pasesur / dytesor)	Pr	Pasesur	1.0
		Dytesor	0.1
Koha e vlefshmërisë	V_r	Per çdo javë, Një muaj baraz 4 javë, një vit baraz 52 javë	0.02 / per javë

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR
2015 Tarifat Kombëtare dhe Udhëzimet

Tabela A-3 LIDHJE FIKSE RADIO (LIDHJE FIKSE WIRELESS PIKE-SHUME PIKA ME DISTANCE MBI 1 km)

TE DHENAT E LIDHJES					VARIABLAT E VLERESUAR						FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetuese (Nrx)	Numri i popullsisë në zonën e licencimit / autorizimit (N)	Koha e vlefshmërisë (Vr)	B	f	E	Nrx	N	Vr	$P_t = B \cdot f \cdot E \cdot Nrx \cdot N \cdot Vr$ (piket)
Sipas përcaktimit në licencë / autorizim / leje përdorimi					Sipas tabelës së mëposhtme						

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERË E VARIABLIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve të CEPT dhe ITU	Sasia në MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	f	Deri në 1 GHz	60.0
		1 GHz - 6 GHz	50.0
		6 GHz - 15 GHz	35.0
		15 GHz - 30 GHz	25.0
		Mbi 30 GHz	20.0
Përdorim i përbashkët / ekskluziv	E	Përdorim i përbashkët	1.0
		Përdorim ekskluziv	Nuk zbatohet
Numri i stacioneve transmetues	Nrx	Deri 10 stacione	1.1
		11 deri 20 stacione	1.2
		Mbi 20 stacione	1.4
Numri i popullsisë në zonën e autorizimit / licencimit	N	Deri në 50.000 banorë	1.0
		50.000 - 100.000 banorë	1.1
		100.000 - 200.000 banorë	1.2
		Mbi 200.000 banorë	1.3
Koha e vlefshmërisë	Vr	Per çdo javë: Një muaj haraz 4 javë, një vit haraz 52 javë	0.02 / per javë

Tabela A-4 LIDHJE (RRIJETE) LOCALE FIKSE RADIO (LIDHJE (RRIJETE) LOCALE FIKSE WIRELESS PIKE-SHUME PIKA ME DISTANCE NEN 1 km)

TE DHENAT E LIDHJES						VARIABLAT E VLERESUAR							FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetuese (N _{rx})	Zona e mbulimit (R)	Fuqia e transmetimit (P)	Koha e vlefshmërisë (V _r)	B	f	E	N _{rx}	R	P	V _r	Pt = B · f · E · N _{rx} · R · P · V _r (piket)
Sipas përcaktimit në licencë / autorizim / leje përdorimi						Sipas tabelës së mëposhtme							

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERË E VARIABLIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve të CEPT dhe ITU	Sasia në MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	f	Deri në 1 GHz	14.00
		Mbi 1 GHz	12.00
Përdorim i përbashkët / ekskluziv	E	Përdorim i përbashkët	1.00
		Përdorim ekskluziv	Nuk zbatohet
Numri i stacioneve transmetues	Nrx	Deri 10 stacione	1.0
		11 deri 20 stacione	1.1
		Mbi 20 stacione	1.2
Zona e mbulimit	R	Mbi 1.5 km	1.3
Fuqia e transmetimit	P	20 - 50 mW	0.6
		50 - 100 mW	0.8
		Mbi 100 mW	1.2
Koha e vlefshmërisë	Vr	Per çdo javë: Një muaj haraz 4 javë, një vit haraz 52 javë	0.02 / per javë

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR
2015 Tarifat Kombëtare dhe Udhëzimet

Tabela B-1

SISTEME IMT DERI NE 2 GHz

TE DRENAT E LIDHJES					VARIABLAT E VLERESUAR						FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetuese (N _{TX})	Numri i popullise ne zonen e licencimit / autorizimit (N)	Koha e vlefshmerise (V _T)	B	f	E	N _{TX}	N	V _T	$P_t = B \cdot f \cdot E \cdot N_{TX} \cdot N \cdot V_T$ (pike)
Sipas përcaktimit ne licencat / autorizimet / leje perdorimi					Sipas tabelës se neperdorimit						

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERE E VARIABELIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve te CEPT dhe ITU	Sasia ne MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF	f	Neen 1 GHz	10.0
		1GHz - 2 GHz	8.0
Perdorim i perbashket / ekskluziv	E	Perdorim i perbashket	1.5
		Perdorim ekskluziv	2.0
Numri i stacioneve transmetues	N _{TX}	Deri 100 stacione	8.0
		Mbi 100 stacione	10.0
Numri i popullise ne zonen e autorizimit / licencimit	N	Deri ne 1 000 000 banore	2.4
		Mbi 1 000 000 banore	3.0
Koha e vlefshmerise	V _T	Per çdo jave. Nje muaj buras 4 jave, nje vit buras 52 jave	0.02 / per jave

Tabela B-2

SISTEME IMT MBI 2 GHz

TE DRENAT E LIDHJES					VARIABLAT E VLERESUAR							FORMULA	
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetuese (N _{TX})	Numri i popullise ne zonen e licencimit / autorizimit (N)	Kapaciteti i transmetimit (C)	Koha e vlefshmerise (V _T)	B	f	E	N _{TX}	N	C	V _T	Pt = B · f · E · N _{TX} · N · C · V _T (pikë)
Sipas përcaktimit ne licencat / autorizimet / leje perdorimi					Sipas tabelës se neperdorimit								

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERE E VARIABELIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve te CEPT dhe ITU	Sasia ne MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF	f	2 GHz - 3 GHz	7.5
		Mbi 3 GHz	8.0
Perdorim i perbashket / ekskluziv	E	Perdorim i perbashket	1.5
		Perdorim ekskluziv	2.0
Numri i stacioneve transmetues	N _{TX}	Deri 50 stacione	8.0
		Mbi 50 stacione	10.0
Numri i popullise ne zonen e autorizimit / licencimit	N	Deri ne 500 000 banore	2.4
		Mbi 500 000 banore	3.0
Kapaciteti i transmetimit	C	C ≤ 256 Kbit/s	1.20
		256 Kbit/s < C ≤ 1 Mbit/s	1.10
		Mbi 1 Mbit/s	1.05
Koha e vlefshmerise	V _T	Per çdo jave. Nje muaj buras 4 jave, nje vit buras 52 jave	0.02 / per jave

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR
2015 Tarifat Kombëtare dhe Udhëzimet

Tabela B-3 SISTEMET E LEVIZSRME TOKESORE PRIVATE (SISTEMET PRIVATE TE RADIOKOMUNIKACIONIT PMR, FAMIL, TETRA, etj)

TE DHENAT E SISTEMIT						VARIABLAT E VLERESUAR							FORMULA	
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (f)	Konfigurimi i sistemit (Sc)	Numri i stacioneve matresh (N _{st})	Zona e mbulimit (R)	Vendndodhja gjeografike (L)	Koha e vlefshmërisë (V _t)	B	f	Sc	N _{st}	R	L	V _t	$P_t = B \cdot f \cdot Sc \cdot N_{st} \cdot R \cdot L \cdot V_t$ (pikë)
Sipas përcaktimit në licencë / autorizim / leje përdorimi						Sipas tabelës së mëposhtme								

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERË E VARIABELIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve të CEPT dhe ITU	Sasia në MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	f	Deri në 100 MHz	12.0
		100 MHz - 400 MHz	17.0
		Mbi 400 MHz	36.0
Përdorimi i përhapshëm / ekskluziv	E	Përdorim i përhapshëm	1.0
		Përdorim ekskluziv	Nuk zbatohet
Konfigurimi i sistemit	Sc	Përcaktues i stacione bazë + pajisje fardore (dore / makine)	8.0
		Përcaktues i stacione bazë + pajisje fardore (dore / makine)	7.0
		Pajisje fardore (dore / makine)	5.0
Numri i stacioneve matresh	N _{st}	Deri në 15 pajisje fardore (dore / makine)	3.6
		16 deri 30 pajisje fardore (dore / makine)	5.5
		Mbi 30 pajisje fardore (dore / makine)	5.0
		R ≤ 15 km	1.20
Zona e mbulimit	R	15 km < R ≤ 30 km	2.20
		30 km < R < 50 km	4.80
		50 km < R < 100 km	1.20
Vendndodhja gjeografike	L	Ballkani Tiranë	1.20
Koha e vlefshmërisë	V _t	Pa garanti për gjatësi të territorit të vendit	1.00
		Per çdo javë. Një muaj bazaz 4 javë, një vit bazaz 52 javë	0.02 / per javë

Tabela B-4 RRJETET E PAVARURA OPERATIVE (SISTEMET E RADIO-ALARMIT, SISTEMET RADIO TE SIGURISE DHE MBIQYRJES, etj)

TE DHENAT E LIDHJES					VARIABLAT E VLERESUAR					FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetuese (N _{tx})	Zona e mbulimit (R)	Koha e vlefshmërisë (V _t)	B	f	N _{tx}	R	V _t	$P_t = B \cdot f \cdot N_{tx} \cdot R \cdot V_t$ (pikë)
Sipas përcaktimit në licencë / autorizim / leje përdorimi					Sipas tabelës së mëposhtme					

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERË E VARIABELIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve të CEPT dhe ITU	Sasia në MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	f	Deri në 100 MHz	12.0
		100 MHz - 400 MHz	17.0
		Mbi 400 MHz	36.0
Numri i stacioneve transmetuese	N _{tx}	Deri në 5 stacione	7.0
		6 deri 15 stacione	8.0
		Mbi 15 stacione	9.0
Zona e mbulimit	R	R ≤ 15 km	6.0
		15 km < R ≤ 30 km	10.0
		30 km < R < 50 km	18.0
Koha e vlefshmërisë	V _t	Pa garanti për gjatësi të territorit të vendit	1.00
		Per çdo javë. Një muaj bazaz 4 javë, një vit bazaz 52 javë	0.02 / per javë

Tabela B-5

SHERBIMI PAGING (PER LIDHJEN PIKE -SHUMEPIKE)

TE DHENAT E LIDHJES				VARIABLAT E VLERESUAR					FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetues e (N _{TX})	Koha e vlefshmerise (V _T)	B	f	E	N _{TX}	V _T	Pt = B · f · E · N _{TX} · V _T (pike)
Sipas përcaktimit ne license / autorizim / leje perdorimi				Sipas tabelës se mëposhteme					

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERE E VARIABLIT
Gjerësia e brezit	B	Sipas Rekomandimeve te CEPT dhe ITU	Sasia ne MHz
Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF	f	Deri ne 100 MHz	60.0
		100 MHz - 300 MHz	70.0
		Mbi 300 MHz	80.0
Perdorim i përbashket / ekskluziv	E	Perdorim i përbashket	1.0
		Perdorim ekskluziv	Nuk zbatohet
Numri i stacioneve transmetues	N _{TX}	Deri 3 stacione	20.0
		4 deri 10 stacione	30.0
		Mbi 10 stacione	45.0
Koha e vlefshmerise	V _T	Per çdo jave. Nje muaj buraz 4 jave, nje vit buraz 52 jave	0.02 / per jave

Tabela C-1

SHERBIMET FIKSE SATELITORE (STACION FIKS SATELITOR PERPISHRE VSAT, STACIONE TOKESORE ME KAPACITET TE LARTE, STACIONE PER SNG, etj)

TE DHENAT E LIDHJES					VARIABLAT E VLERESUAR					FORMULA
Gjerësia e brezit (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF (f)	Numri i stacioneve transmetuese (N _{TX})	Fuqia e transmetimit (P)	Koha e vlefshmerise (V _T)	B	f	N _{TX}	P	V _T	$Pt = B \cdot f \cdot N_{TX} \cdot P \cdot V_T$ (pike)
Sipas përcaktimit ne license / autorizim / leje perdorimi					Sipas tabelës se mëposhteme					

VARIABLAT E VLERESUAR		NDARJA	VLERE E VARIABLIT
Gjerësia e brezit	B	Deri ne 500 KHz	8.0
		500 KHz - 2 MHz	10.0
		2 MHz - 11 MHz	16.0
		11 MHz - 40 MHz	20.0
		Mbi 40 MHz	40.0
Frekuenca qendrore / pozicioni ne spektrin RF	f	Deri ne 3 GHz	7.0
		3 GHz - 10 GHz	6.0
		10 GHz - 15 GHz	5.0
		Mbi 15 GHz	4.0
Numri i stacioneve transmetues	N _{TX}	Deri ne 5 stacione	1.3
		6 deri 15 stacione	3.0
		Mbi 15 stacione	6.0
Fuqia e transmetimit	P	Deri ne 6 Wat	1.4
		6 Wat - 30 Wat	1.6
		30 Wat - 150 Wat	1.8
		Mbi 150 Wat	2.0
Koha e vlefshmerise	V _T	Per çdo jave. Nje muaj buraz 4 jave, nje vit buraz 52 jave	0.02 / per jave

Tabela C-2

SISTEMET E LEVIZSHME SATELITORE (SISTEMET E LEVIZSHME TOKESORE
PËRPSHIRË GMPCS, SISTEMET E RADIOLOKACIONIT SATELITOR, etj.)

TËDHËNAT E LIDHËS			VARIABLAT E VLERËSUAR					FORMULA
Gjerësia e frekuencës (B)	Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF (f)	Koha e vlefshmërisë (V _r)	B	f	V _r			$P_t = B \cdot f \cdot V_r$ (pW)
Signat përkatësit në licencë / autoritativ / kështu përdoret			Signat tabelës së nevojshme					

VARIABLAT E VLERËSUAR		NDARJA	VLERË E VARIABELIT
Gjerësia e frekuencës	B	Deri në 100 KHz	10.0
		100 KHz - 2 MHz	11.0
		Mbi 2 MHz	12.0
Frekuenca qendrore / pozicioni në spektrin RF	f	Deri në 3 GHz	20.0
		3 GHz - 10 GHz	25.0
		Mbi 10 GHz	30.0
Koha e vlefshmërisë	V _r	Për çdo javë. Një muaj herat 4 javë, një vit herat 52 javë	0.02 / për javë

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR
2015 Tarifat Kombëtare dhe Udhëzimet

Tabela D-1 : Shërbimi Aeronautik

Nr	Stacioni / Paisja transmetuese	Tarifa (leke/vit)	SHENIME
1	Stacion baze ne toke	10,000	
2	Stacion i levizshem ne toke	7,500	
3	Stacion portativ ne toke	5,000	
4	Terminal satelitor ne avion	40,000	
5	Radare dhe paisje te radionavigacionit aeronautik	3,000	Per çdo radar / paisje
6	Stacionet e avionit me aftesi ngritese :		
	a) Deri ne 3.200 kg	5,000	
	b) 3.200 kg - 14.000 kg	40,000	
	c) Mbi 14.000 kg	80,000	

Tabela D-2 : Shërbimi detar

Nr	Stacioni / Paisja transmetuese	Taksa (leke/vit)	SHENIME
1	Stacion bregdetar	10,000	Per çdo stacion baze
2	Radare dhe paisje radionavigacioni	2,500	Per çdo paisje
3	Radio per operacione portuale	1,500	Per çdo paisje
4	Stacione baze ne anije (HF, VHF, UHF)	5,000	Per çdo paisje
5	Stacion portativ ne anije	500	Per çdo paisje
6	Terminal satelitor ne anije INMARSAT	3,000	Per çdo paisje

EMERTIMI I SHËRBIMIT SIPAS PËRQË	FORMULA E PËRGJITHSHME [$P_t = R \cdot a \cdot f \cdot E \cdot S \cdot D \cdot P \cdot H \cdot C \cdot M_a \cdot N_{TX} \cdot N_{RX} \cdot R \cdot V_T \cdot D_e \cdot N \cdot L \cdot R \cdot GDP$]																		TOTALI (qaka)	KORFICIENTI I VLERËSIMIT (K) (leke / qaka)	VLERË E PËRLOGARITUR E TAKSËS (leke)
	R	a	f	E	S	D	P	H	C	M _a	N _{TX}	N _{RX}	R	V _T	D _e	N	L	R	GDP		
Shërbimet e Tabelës A-1	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës A-2	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës A-3	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës A-4	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës B-1	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës B-2	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës B-3	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës B-4	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës C-1	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000
Shërbimet e Tabelës C-2	1.000	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.000	1,000.0	1,000

MINISTRI I FINANCAVE

Shkëlqim Cani

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES TË

AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE

ELEKTRONIKE DHE POSTAR

Piro Xhixho

Agjenti AMA

UDHËZIM

Nr.32, datë 29/12/2014/2014

**“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E
TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i AMA-s

UDHËZOJNË:

1. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) caktohet agjent për vjeljen e tarifës së shërbimit të transmetimeve radiotelevizive.
2. Llogaritjet teknike të tarifës bëhen nga AMA sipas shtojcës nr.1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive në cilësinë e agjentit të mbledhjes të kësaj tarife është i detyruar;

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklarimet.

b) të paguaj për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.09.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të Ministrit të Financave”. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga AMA nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. AMA duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifën .

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

5. Për shërbimin e kryer, AMA mban 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 95% të shumës së arkëtuar.

AMA vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimeve nga tarifën për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton si dhe deklaron dhe paguan në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

6. Udhëzimi nr. 36, datë 11.11.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive“ shfuqizohet.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCEVE
SHKËLQIM CANI

KRYETAR I AUTORITETIT
TË

MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHTOJCA NR.1

TARIFAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore, radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë:

1. Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor:
 - a) me fuqi të rrezatuar deri në 10 Ë 1500 lekë në vit;
 - b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 Ë 6000 lekë në vit;
 - c) me fuqi të rrezatuar deri në 1000 Ë 24 000 lekë në vit
 - ç) me fuqi të rrezatuar deri në 10 000 Ë 48 000 lekë në vit;
 - d) me fuqi të rrezatuar mbi 10 000 Ë 60 000 lekë në vit.
2. Për çdo transmetues ose përsëritës radio FM tokësore:
 - a) me fuqi të rrezatuar deri në 10 Ë 300 lekë në vit;
 - b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 Ë 1200 lekë në vit; c)
 - me fuqi të rrezatuar deri në 1000 Ë 4800 lekë në vit; ç)
 - me fuqi të rrezatuar deri në 10 000 Ë 9600 lekë në vit;
 - d) me fuqi të rrezatuar mbi 10 000 Ë 12 000 lekë në vit.
3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.
4. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur mbi këto pika shumëzohet me koeficientin 2.
5. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50 000 deri në 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1.5.
6. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3, 4, 5, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.
7. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.
Operatorët radio dhe/ose televizivë të ritransmetimit të programeve të huaja me përsëritës të licencuar nga AMA paguajnë vetëm 20 për qind të tarifave të përcaktuara më sipër.

UDHËZIM

Nr .33, datë 29/12/2014

“Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor "shtetëror", prokurorisë dhe noterisë ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, prokurori, dhe noterisë caktohen sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Agjent për mbledhjen e tarifave për kryerjen e veprimeve e të shërbimeve administrative në gjykata, Ministrinë e Drejtësisë, prokurorisë caktohen administratat përkatëse të këtyre institucioneve, ndërsa agjent për mbledhjen e tarifës të shërbimit noterial, caktohet "Posta Shqiptare" sh.a.

4. Tarifat paguhen në momentin e kryerjes së veprimeve dhe bëhen me anën e pullës për tarifat fikse ose me mandatarëkëtim për ato raste kur, kjo tarifë sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur, është shprehur në përqindje.

5. Termi "tarifë" në pikën 8 të shkronjës "A" të shtojcës 1, ka të njëjtin kuptim me termin "taksë mbi aktet" i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile.

6. Pullat vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që, sipas ligjit, duhet të pajisen me pulla. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla është e vulosur nga organi që kryen shërbimin. Për plotësimin e vlerës së pullës për aktet që lëshohen mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të plotësojnë vlerën e tarifës.

7. Në rast se personi kërkon kopje të akteve apo dokumenteve të lëshuara nga organet gjyqësore apo noteriale, vlera e pullës është përcaktuar në shtojcën nr.1, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje". Në rast të kundërt merret vlera e plotë e tarifës.

8. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore apo noteriale.

9. Institucionet përgjegjëse për vjeljen e tarifave me anën e pullës planifikojnë dhe porosisin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat sipas nevojave.

10. Mbi tarifatat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.

11. Këto tarifa aplikohen në çdo rast pavarësisht tarifave të shërbimit, të parashikuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore.

12. Administrata e gjykatave, prokurorisë, Ministria e Drejtësisë dhe “Posta Shqiptare” në cilësinë e agjentëve të mbledhjes së tarifave në përputhje me këtë udhëzim detyrohen ;

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzimin nr. 26, datë 4.09.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të Ministrit të Financave. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga agjentet nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ëëë. [.tatime.gov.al](http://tatime.gov.al).

Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. Agjentet e percaktuar me këtë udhëzim duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifatat .

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

13. Për shërbimin e kryer, institucionet përkatëse të gjykatës, Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorisë përfitojnë 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që kanë arkëtuar .

14.Posta Shqiptare sh.a. për shërbimin e kryer përfiton 3% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar

15. Agjentët në përputhje me këtë udhëzim vetëllogarisi shumën që përfitojnë nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimit nga tarifatat për periudhën tatimore dhe mbajnë drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfitojnë, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfitojnë.

16. Udhëzimi nr. 13, datë 12.02.2009, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë”, I ndryshuar, shfuqizohet.

17. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCEVE

SHKËLQIM CANI

MINISTËR I DREJTËSISË

NASIP NAÇO

SHTOJCA NR.1

TARIFA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA GJYQËSORE, MINISTRIA E DREJTËSISË, PROKURORIA DHE NOTERIA

Masa e tarifës në lekë

Masa e tarifës në %

A. Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:

1 Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit 200

2 Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit 200

3 Për lëshimin e dëshmisë së penaltetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore 200

4 Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtsis 200

5 Për lëshimin e vërtetimit së ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria 200

6 Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria 200

7 Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata së kërkuesi nuk është në proces gjyqësor 200

8 Kërkesëpadi që paraqiten në gjykate:

a) për pension ushqimor 0

b) për vërtetim fakti 200

c) padi për zgjidhje martese 3000

ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike 3000

d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi: 3000

I) me vleftë deri 100 000 lekë 3000

II) me vleftë mbi 100 000 lekë 1%

dh) padi për përpjesëtim pasurie 3000

e) padi për kthim në punë 0

9 Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës 200

B. Tarifë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror:

1. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm 3500

2. Për vënien në ekzekutim të vendimeve të titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:

a) kundrejt shtetasve 2%

b) kundrejt personave juridikë 2%

3. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor 200

4. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit

200

5. Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor 0 C.

Tarifa e pullës që zbatohet për veprimet që kryhen nga zyrat noteriale:

1. Përpilimi i testamenteve me akte noteriale 450

2. Depozitimi i testamenteve ollografe 200

3. Prokura (redaktim):

a) të përgjithshme 200

b) të posaçme 200

4. Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale 200

5. Vërtetim se kopjet ose shkurtime e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin 200

6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësie me origjinalin 200

7. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme 700

8. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme 1000

9. Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme 200

10. Njoftim dhe kujtesë noteriale ose akte të tjera jashtëgjyqësore 200

11. Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte të ndryshme 200

12. Pranimi për ruajtje të dokumenteve të personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale 300

13. Vërtetimi i qenies së një personi dhe qëndrimi i tij në një vend të caktuar 200

14. Kundërshtimi i çekut dhe kambialit (protesta) 200

15. Kontratë qiraje 200

16. Kontratë huaje 200

17. Kontratë sipërmarrje 200

18. Veprime të tjera noteriale 200

Agjenti DPSHTRR

UDHËZIM

Nr.34 , datë 29/12/2014

“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtimin e automjeteve është si më poshtë:
 - a) për lejedrejtimi të kategorisë A 3 000 (tre mijë) lekë;
 - b) për lejedrejtimi të kategorisë B 4 500 (katërmijë e pesëqind) lekë;
 - c) për lejedrejtimi të kategorisë C 2 000 (dy mijë) lekë;
 - ç) për lejedrejtimi të kategorisë D 3 000 (tre mijë) lekë;
 - d) për lejedrejtimi të kategorive BE, CE dhe DE 3 000 (tre mijë) lekë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor caktohet agjent për mbledhjen e tarifës të paisjes me leje drejtimi .
3. Shtetasit që paisen me leje drejtimi paguajnë tarifën në momentin e dhënies së dëshmisë së aftësisë për drejtim automjeti.

4. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj tarife. Të gjitha pagesat e tarifës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas shtojcës nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor , në cilësinë e agjentit të mbledhjes të kësaj tarife është i detyruar;

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguaj për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.09.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të Ministrit të Financave. Deklarata plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga DPSHTRR nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al . Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. DPSHTRR duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifë .

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

5. Për shërbimin e kryer, DPSHTRR mban 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 95% të shumës së arkëtuar.

DPSHTRR vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimeve nga tarifë për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton si dhe deklaron dhe paguan në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

6. Udhëzimi nr. 34, datë 27.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për pajisjen me lejedrejtimi“ shfuqizohet.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare .

MINISTRI I FINANCAVE

SHKËLQIM CANI

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE

INFRASTRUKTURËS

EDMOND HAXHINASTO

SHTOJCA 1:

**REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË PAJISJES ME LEJEDREJTIMI PËR DREJTIM
AUTOMJETI**

Nr. Emër, mbiemër Lloji i lejes së drejtimit Masa e tarifës Nr.i mandatarkëtimit

Drejtoria rajonale e transportit rrugor

UDHËZIM

Nr. 37datë/31/12/2014

**“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET KONSULLORE
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME APO TË AMBASADAVE TONA JASHTË
VENDIT“**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 e Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

1. Ministria e Punëve të Jashtme me institucionet e vartësisë caktohen agent për mbledhjen e tarifave për shërbimet konsullore, të cilat caktohen në përputhje me shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, në bazë të shtojcës nr.1, niveli i tarifës përcaktohet në euro dhe pagimi i tyre mund të bëhet në euro, dollarë ose në monedhen e vendit ku kryhet shërbimi, konvertuar me kursin përkatës ditor të këmbimit.

3. Për tarifatat e arkëtuara brenda vendit si dhe për tarifatat e arkëtuara nga përfaqësitë tona diplomatike Ministria e Punëve të Jashtme në cilësinë e agentit të mbledhjes të këtyre tarifave është e detyruar:

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa , jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguaj për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën e arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.09.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të Ministrit të Financave. Deklarata për pagesën e tarifës kombëtare plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga MPJ nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. MPJ duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifatat .

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

4. Me termin "përfaqësi" kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Tarifatat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse.

5. Tarifatat e arkëtuara brenda vendit derdhen brenda ditës në llogarinë bankare të thesarit për llogari të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Përfaqësitë tona diplomatike raportojnë çdo muaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi tarifatat e arkëtuara prej tyre. Ministria e Punëve të Jashtme transferon brenda datës 15 të çdo muaji , në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit , shumën

totale të tarifave sipas raportimit të bërë nga prfaqsitë diplomatike. Çdo muaj Ministria e Punëve të Jashtme rakordon me degët respektive të thesarit.

Shuma e tarifave të arktuara sipas këtij udhëzimi, i takojnë 100% buxhetit të shtetit.

6. Për vjeljen e tarifave konsullore me anën e pullës, Ministria e Punëve të Jashtme planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat konsullore për nevojat e saj dhe të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

7. Udhëzimi Nr.38, datë 21.11.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të ministrisë së punëve të jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit dhe tarifa për lëshimin e pasaportave të udhëtimit” shfuqizohet .

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zrtare .

MINISTRI I FINANCAVE

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME

MINISTRI I BRENDSHËM

SHTOJCA NR.1

TARIFAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE

I. Tarifat për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit:

1. Për lejkalimi 200 lekë;

2. Lejkalimi lëshuar nga përfaqësitë 30 euro.

1. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 30 euro;

2. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj reciprocitet;

3. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 30 euro;
4. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj reciprocitet;
5. Verifikimi i dokumentit nga përfaqësitë 10 euro;
6. Legalizimi i dokumentit për shtetasit shqiptarë nga Ministria e Punëve të Jashtme 200 lekë;
7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë 20 euro;
8. Legalizimi i dokumentit për shtetasit e huaj reciprocitet.

III. Tarifat për lëshimin e përpilimin e akteve të tjera noteriale dhe përkthimin e dokumenteve nga përfaqësitë.

1. Përpilimi i deklaratave, autorizimeve, testamenteve kontratave, garancive dhe prokurave të posaçme nga përfaqësitë 20 euro/faqe;
2. Vërtetimi i dublikatave dhe kopjeve 20 euro/faqe;
3. Përkthimi i dokumenteve 10 euro/faqe.

UDHËZIM

Nr. 1917, datë 1.9.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZOJNË:

1. Tarifat e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, është 10 euro dhe paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës, tek shoqëritë ajrore, pavarësisht vendit apo mënyrës së shitjes së biletës.

2. Tarifa e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë është një pagesë e detyrueshme që bëhet për llogari të buxhetit të shtetit nga çdo udhëtar që del nga territori i Republikës së Shqipërisë në drejtim të destinacioneve jashtë, përveç rastit kur udhëtari është transit dhe nuk e kalon kufirin, por qëndron në ambientet e aeroportit deri në vazhdimin e udhëtimit të tij.

3. Shoqëria "Tirana International Airport" (TIA) caktohet agjent për mbledhjen e tarifës të kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Të kryejë, në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit dhe këtij udhëzimi, të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj tarife në sistemin e IATA-s.

b) Të llogarisë shumën e tarifës kombëtare që duhet të paguhet në buxhetin e shtetit për çdo shoqëri ajrore, mbështetur në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve dhe në përputhje me vlerën e biletave të shitura, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

c) Për zbatimin e paragrafit "b" të kësaj pike, TIA-ja detyrohet të rakordojë dhe të faturojë brenda datës 5 të muajit pasardhës me secilën nga shoqëritë ajrore, tarifën 10 euro/pasagjer për kalimin me avion të RSH-së, për muajin paraardhës bazuar në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve për muajin paraardhës (biletën e udhëtimit). TIA-ja mban aktin e rakordimit me secilën shoqëri ajrore ku evidentohet numri i pasagjerëve që kanë kaluar kufirin, numri dhe vlera e biletave të udhëtimit dhe llogaritjet për vlerën përkatëse të tarifës kombëtare që secila shoqëri ajrore detyrohet t'i paguajë TIA-s si agjent, person përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e shtetit të kësaj të ardhure prej tarifës. Rakordimi do të merret i mirëqenë dhe do të konsiderohet i bërë me lëshimin e faturës nga TIA-ja për shoqëritë ajrore. Aktrakordimi i mbajtur dhe fatura e lëshuar nga TIA-ja për shoqëritë ajrore, përmban detyrimin e tarifës për të cilin TIA-ja si agjent është përgjegjës të llogarisë, të arkëtojë dhe të paguajë (të transferojë) në buxhetin e shtetit.

d) Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit (biletave të udhëtimit) të pasagjerëve dhe këto dokumente arshivohen dhe janë në ruajtje nga TIA-ja.

e) Shoqëritë ajrore brenda datës 10 të të njëjtit muaj, paguajnë detyrimin për shumën e tarifës për t'u paguar sipas faturës dhe aktit të rakordimit me TIA-në, në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TIA-ja, e cila e transferon atë në buxhetin e shtetit brenda datës 15 të muajit.

~~f) Në rast moslikuidimi nga shoqëritë ajrore brenda datës 15 të muajit pasardhës të shumave të faturuara, TIA dërgon një njoftim të dytë në rrugë elektronike ose me postë shoqërive ajrore ku kërkon likuidimin e menjëhershëm të shumave mbi bazën e faturimeve të bëra dhe nëse edhe mbas këtij njoftimi nuk bëhet likuidimi nga shoqëritë ajrore, TIA evidenton shumat e faturuara dhe të likuiduara për efekt të plotësimit të formularit të deklarimit.~~

f) TIA-ja detyrohet të deklarojë dhe të transferojë, në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, brenda datës 15 të të njëjtit muaj për muajin paraardhës shumat e faturuara për shoqëritë ajrore, sipas "Formularit të deklarimit të tarifave kombëtare", bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare".

~~h) Të evidentojë shumat e faturuara dhe të arkëtuara nga tarifa e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, si dhe detyrimet e paarkëtuara.~~

(Ndryshuar dhe shfuqizuar me Udhëzim Nr. 19, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 16.07.2020)

4. Shoqëritë ajrore, të cilat kanë përgjegjësinë që të arkëtojnë prej pasagjerëve nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferojnë shumat e arkëtuara në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TIA-ja, ngarkohen me detyrat e mëposhtme:

5.

a) Pas kryerjes nga TIA, në përputhje me germën "a", të pikës 3, të këtij udhëzimi, të regjistrimit në sistemin e IATA-s të tarifës, çdo shoqëri ajrore në momentin e shitjes së biletave, duhet t'i shtojë këtë tarifë vlerës së biletës, si dhe ta pasqyrojë në të vlerën e tarifës të kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

b) Të arkëtojnë tarifën e paguar nga udhëtarët, nëpërmjet shitjes së biletave **si pjesë e çmimit të biletës**.

c) Të rakordojnë me TIA-në për tarifën e faturuar për muajin paraardhës, brenda datës 5 të muajit pasardhës dhe të transferojnë për llogari të TIA-së shumat e faturuara, brenda datës 10 të muajit.

d) Të mbajnë dokumentacionin përkatës për numrin e biletave të shitura, numrin e biletave të anuluar dhe shumat e kthyer paguesve të tarifës.

Degët, apo zyrat e përfaqësimit në Shqipëri të shoqërive ajrore të huaja, janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë udhëzim në përputhje me tagrin e dhënë në përfaqësim.

(Ndryshuar dhe shtuar me Udhëzim Nr. 19, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 16.07.2020)

5. Mbi tarifatat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.

6. Për shërbimin e kryer, TIA mban 5% komision të llogaritur mbi masën e ~~tarifave që ka arkëtuar~~ **tarifave që ka faturuar** dhe transferon në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar ~~95% të shumës së arkëtuar~~ **95% të shumës së faturuar**.

(Zevendesuar me Udhëzim Nr. 19, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 16.07.2020)

7. Për mosrespektim nga TIA-ja të detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, zbatohen sanksionet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 10 të ligjit nr. 9985, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, si dhe të udhëzimeve në zbatim të tyre.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 19, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 16.07.2020)

~~8. Për mosrespektim, nga degët e shoqërive të huaja ajrore në Shqipëri, si dhe nga shoqëritë ajrore vendase, të detyrimeve të përcaktuara në dispozitën 4, gjerat "a", "b", "c", "d" për këto subjekte zbatohen sanksione në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".~~

(Shfuqizuar me Udhëzim Nr. 19, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 16.07.2020)

9. Formulari i paraqitur në aneksin bashkëlidhur, do të jetë në fuqi deri në informatizimin e sistemit të tarifave dhe unifikimin e formularit të deklarimit.

10. Ky udhëzim shfuqizon udhëzimin nr. 40, datë 24.12.2008 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ndryshuar:

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 19, datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 16.07.2020

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCAVE

Shkëlqim Cani